



Udhërrëfyese për Zbatimin e Procesit të Rishikimit Mbikëqyrës

*Udhërrëfyese për Zbatimin e Procesit të Rishikimit Mbikëqyrës është miratuar
nga Bordi Ekzekutiv më 28 shkurt 2025*

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës synon të zbatojë gradualisht Procesin e Rishikimit Mbikëqyrës, duke marrë parasysh specifikat e sektorit bankar në Republikën e Kosovës, për të siguruar që praktikat mbikëqyrëse të jenë të përshtatshme dhe proporcionale me madhësinë, fushëveprimin dhe kompleksitetin e sistemit bankar. Për më tepër, BQK synon të përmirësojë sistemin e vlerësimit të rrezikut duke përzgjedhur kriteret përkatëse dhe duke rafinuar udhëzimet për vlerësimin, duke u mbështetur në analizën e rregullt prudenciale të të dhënave dhe për të arritur rezultate më të harmonizuara të vlerësimit të rrezikut.

BQK synon të kalojë nga sistemi aktual i vlerësimit CAMELS në Procesin e Vlerësimit të Rishikimit Mbikëqyrës (SREP), në përputhje me parimet e përcaktuara nga Udhëzimet e Autoritetit Bankar Evropian (EBA).

Qëllimi kryesor i SREP është monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i rreziqeve ndaj të cilave ekspozohen bankat, si dhe krijimi i një strategjie mbikëqyrëse të përshtatshme, me qëllim final ruajtjen ose përmirësimin e gjendjes në banka dhe në sistemin bankar në tërësi.

BQK synon të forcojë kornizën e saj mbikëqyrëse të bazuar në rrezik, veçanërisht kornizën e vlerësimit të rrezikut dhe Instrumentet e Shtyllës 2, për të zbatuar modelin e Procesit të Rishikimit Mbikëqyrës (SRP) të BE-së.

Elementet kryesore të këtij udhërrëfytyesi do të përfshijnë hartimin e një drafti fillestar të manualit SREP, pilotimin e manualit për vlerësimin e disa bankave, përditësimin e draftit të manualit bazuar në reagimet nga faza pilot dhe finalizimin e manualit. Përveç kësaj, udhërrëfytyesi përshkruan planin për trajnimin e stafit, organizimin e konsultimeve dhe bashkëpunimit me bankat vendore dhe palët e tjera të interesit për SREP, si dhe caktimin e një date synuese për zbatimin e plotë të manualit SREP.

BQK njeh rëndësinë e Procesit të Rishikimit Mbikëqyrës, duke marrë parasysh se:

- Procesi i rishikimit mbikëqyrës synon jo vetëm të sigurojë që bankat kanë kapital dhe likuiditet të mjaftueshëm për të mbështetur të gjitha rreziqet në veprimtarinë e tyre, por edhe t'i inkurajojë ato të zhvillojnë dhe të përdorin teknika më të mira të menaxhimit të rrezikut për monitorimin dhe menaxhimin e këtyre rreziqeve.
- Procesi i rishikimit mbikëqyrës njeh përgjegjësinë e menaxhmentit të bankës për zhvillimin e një procesi të vlerësimit të kapitalit të brendshëm dhe përcaktimin e objektivave të kapitalit që janë të përshtatshme me profilin e rrezikut dhe mjedisin e kontrollit të bankës. Menaxhmenti i bankës vazhdon të mbajë përgjegjësinë për të siguruar që banka ka kapital të mjaftueshëm për të mbështetur rreziqet e saj, përtej kërkesave minimale themelore.
- BQK pritet të vlerësojë se sa mirë bankat vlerësojnë nevojat e tyre për kapital në lidhje me rreziqet dhe të ndërhyjë, kur është e nevojshme. Ky ndërveprim ka për qëllim të nxisë një dialog aktiv ndërmjet bankave dhe BQK-së, në mënyrë që kur të identifikohen mangësi, të merren masa të shpejta dhe vendimtare për të reduktuar rrezikun ose për të rikthyer kapitalin. Për këtë arsye, BQK dëshiron të adoptojë një qasje që të përqendrohet më intensivisht në ato banka me profile rreziku ose përvojë operative që kërkojnë një vëmendje të tillë.
- BQK njeh ndërlidhjen që ekziston ndërmjet shumës së kapitalit që banka mban kundrejt rreziqeve dhe forcës dhe efektivitetit të proceseve të menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit

të brendshëm të bankës. Megjithatë, rritja e kapitalit nuk duhet të shikohet si opsioni i vetëm për adresimin e rreziqeve të shtuar që përballet banka. Mjete të tjera për adresimin e rrezikut, si forcimi i menaxhimit të rrezikut, vendosja e kufizimeve të brendshme, forcimi i nivelit të provizioneve dhe rezervave, dhe përmirësimi i kontrolleve të brendshme, duhet gjithashtu të merren në konsideratë. Për më tepër, kapitali nuk duhet të konsiderohet si zëvendësim për adresimin e proceseve të menaxhimit të rrezikut ose të kontrollit të brendshëm që janë të pamjaftueshme në bazë.

Udhërrëfytyesi i SREP është ndërtuar mbi:

- Analizën e modelit të biznesit;
- Vlerësimin e rregullimeve të qeverisjes së brendshme dhe kontrolleve në nivel institucioni;
- Vlerësimin e rreziqeve ndaj kapitalit dhe mjaftueshmërisë së kapitalit për të mbuluar këto rreziqe; dhe
- Vlerësimin e rreziqeve ndaj likuiditetit dhe mjaftueshmërisë së burimeve të likuiditetit për të mbuluar këto rreziqe.


Udhërrëfytyesi i SREP përfshinë rekomandimet e dhëna nga FMN për BQK gjatë misionit të tyre në dhjetor 2024, si pjesë e Asistencës Teknike (TA) për Procesin e Rishikimit Mbikëqyrës.

Afati kohor i detajuar për zbatimin e udhërrëfytyesit të SREP është ofruar në Shtojcën 1, i cili është pjesë përbërëse e këtij udhërrëfytyesi.

Shtojca 1


Udhërrëfytyesi dhe veprimet

Udhërrëfytyesi për vitin 2025



Udhërrëfytyesi dhe veprimet

Udhërrëfytyesi për vitin 2026



Udhërrëfytyesi dhe veprimet

Udhërrëfytyesi për vitin 2026

